



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 96, Datë 20.04.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES SË VEÇANTË PËR L SHIMIN, TRANSFERIMIN DHE ANULIMIN
E GARANCIVE T ORIGJIN S**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 16 pika 13 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit dhe Funksionimit të ERE”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “draft – Rregullore s veçant p r krijimin e nj sistemi t sakt , t besuesh m e t mbrojtur nga abuzimet p r l shimin, transferimin dhe revokimin e garancive t origjin s,

Konstatoi se:

- Neni 16 pika 13 i Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i jep të drejtën ERE të miratojë nj rregullore t veçant p r krijimin e nj sistemi t sakt , t besuesh m e t mbrojtur nga abuzimet p r l shimin, transferimin dhe revokimin e garancive t origjin s.
- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullore s veçantë për l shimin, transferimin dhe anulimin e garancive t origjin s”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI